



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2570/3 prot

Datë 21.11.2023

V E N D I M
Nr. 1198/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.11.2023 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-83536-10-12-2023, me objekt “*Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)*” me fond limit 2,691,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK me NIPT: L81506043D
Adresa: Rruga “Idriz Dollaku”, Ali Demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i parë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Korçë
Adresa: Bulevardi Shën Gjergji, L.12
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-83536-10-12-2023, me objekt “Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)” me fond limit 2,691,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 23.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3520 dhe me nr. 2570 prot., datë 23.10.2023 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Me shkresën nr. 8431/4 prot., datë 30.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2570/2 prot., datë 03.11.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi nr. 8431/2 prot., datë 27.10.2023 i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “INSTANT.AL” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 8431/4 prot., datë 30.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2570/2 prot., datë 03.11.2023 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK ku ka vendosur refuzimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “INSTANT.AL” SHPK në lidhje me specifikimet teknike të pajisjeve Kompjuter Desktop1, KOMPJUTERA Workstation, FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A4, FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në specifikimet teknike bashkëlidhur dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“KOMPJUTERA

Desktop 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net :	4500 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	256 GB SSD
“Disk Subsystem Controler”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 22”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz

Raporti i Kontratit "Constrast Ratio Static":	1000:1
"Display Port":	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë "Energy Efficency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre



KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	10000 Pikë
“RAM”:	16 GB, min. DDR4-2666 MHz, ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	(1) x 500 GB SSD Sistemi Operativ dhe 1000 GB HDD
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD
“Disk Subsystem Controler”:	Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1)
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 5 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.
“Media Device”:	DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity
“Slots”:	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal speakers or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 24"
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
“Display Port”:	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier/Printer
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:	≥ 40 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 150 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25% to 400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	ADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	500 Fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”:	200 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Dublex Copy/Print
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 1024 MB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	≥ 30 ppm
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600x600dpi
Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:	A4
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0, Ethernet Port
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 B&W”:	≥ 40 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 20 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color/B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25% - 400%
Vendosja e Letrës “Document Feeder”:	ADF
Sirtaret per Letrën “Paper Trays”:	min 1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min.”:	500 Fletë (jo Bypass)
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min. Standard”:	500 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Dublex
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 2 GB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	≥ 30 ppm
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	1200 x 1200 dpi
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0, Ethernet Port
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

”.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”
Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo

sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.5. Nga shqyrtimi i “Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, të publikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me specifikimet e mësipërme, ky i fundit argumentuar:

“II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialist i caktuar me udhërin e Kryetarit Nr 585 date 07.06.2023 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili do të publikohet sëbashku me dokumentat e tenderit.”

III.1.6. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit nuk i ka pranuar këto pretendime me arsyetimin si vijon:

“....Nga procesverbali i mbajtur nga specialisti i fushës nuk rezulton që specifikimet teknike të jenë bërë mbështetur në specifikimet e publikuara nga AKSHI, por duke qënë se për disa nga

pajisjet e kërkuara është vendosur në specifikimet teknike shënimi “AKSHI Standartet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre” i është kërkuar sqarim specialistit të fushës.

Specialisti i fushës ka sqaruar për KSHA se ka hartuar specifikimet teknike duke marrë si model referues për artikujt KOMPJUTERA Desktop 1, KOMPJUTERA Workstation, FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A4, FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4, modelin e tabelës nga AKSHI, por specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat konkrete dhe buxhetin e Bashkisë Korçë.

Për këtë arsue në specifikimet teknike ka ngelur shënimi “AKSHI Standartet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre”, por kjo nuk nënkupton se specifikimet teknike dhe akoma më tej llogaritja e fondit të jetë sipas publikimeve të AKSHI-t..”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore,

me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin public” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”*. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjitha kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

III.1.8. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe

GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisjet *KOMPJUTERA Desktop 1, KOMPJUTERA Workstation, FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A4, FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4*, është një kërkesë e cila kushtëzohet nga buxheti i autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Komisioni gjykon se për të hapur më shumë konkurrencën autoriteti kontraktor të vendosë në specifikimet teknike kufirin minimal për pajisjet e sipërpërmendura.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK sa i përket përcaktimit të fondit limit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përcaktimi i fondit limit të një procedure prokurimi është e drejta e Njesisë së Prokurimit e cila bazohet në nevojat reale të autoritetit kontraktor dhe buxhetit të saj.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 24 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor (të njesisë së prokurimit në këtë rast) dhe të rivlerësojë në themel të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit*

Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-83536-10-12-2023, me objekt “*Pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj)*” me fond limit 2,691,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri